



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 940
Dt 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 15, pika 1, nenit 17, pika 1 dhe 2 të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it, vendimit të Senatit nr. prot. 851 të datës 30.05.2018, si dhe nenit 15 të Rregullores mbi Punën e Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 01.06.2018, mori:

VENDIM

- I. Prof. ass. dr. Rifat Morina shkarkohet nga pozita e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Të përmendurit i pushojnë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë, si dhe të gjitha beneficionet e pozitës sipas Rregullores për të ardhura personale të UMIB-it.
- III. Dorëzimi i detyrës së prorektorit bëhet prej momentit të hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga MASHT-i (neni 38 lidhur me nenin 32, pika 3 i Statutit të Përkohshëm).

Arsyetim

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 01.06.2018 shqyrtoi vendimin e Senatit nr. prot. 851 të datës 30.05.2018 për iniciimin e procedurës për shkarkimin e prof. ass. dr. Rifat Morina nga detyra e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë të UMIB-it.

Senati i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2018, ka diskutuar çështjen e funksionimit të Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim të Cilësisë, duke shprehur kritika të mëdha ndaj punës dhe veprimtarisë së prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë. Kritikën nga anëtarët e Senatit janë shprehur kryesisht në raport të ndërprerjes së plotë të bashkëpunimit mes tij dhe strukturave udhëheqëse të Universitetit, si dhe injorimit të plotë të organeve të UMIB-it nga ana e tij. I njëjti ka pasur qasje të papërgjegjshme edhe gjatë procesit të riakreditimit të programeve të studimit të UMIB-it në vitin 2017. Senati, gjithashtu, ka konstatuar se ekziston një përkeqësim-ndërprerje e raporteve të bashkëpunimit mes prorektorit të lartcekur dhe udhëheqësve të njësive akademike të Universitetit, gjë që ka reflektuar dhe po reflekton negativisht në fushëveprimtarinë e këtij institucioni universitar. Andaj, në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2018, Senati i Universitetit, në mënyrë unanime, ka marrë vendim për iniciimin e procedurës së shkarkimit të prof. ass. dr. Rifat Morina nga detyra e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë të UMIB-it (vendimi nr. prot. 851 të datës 30.05.2018).

Bazuar në faktet/arsyetimet e përmendura, Këshilli Drejtues konstatoi edhe një herë se ndërprerja e bashkëpunimit mes prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë dhe strukturave udhëheqëse të Universitetit, si dhe mosfunksionimi i resorit të cilin i përmenduri e përfaqëson nuk i ndihmon zhvillimit të Universitetit në përgjithësi, përkundrazi e cënon atë. Andaj, Këshilli Drejtues bazuar në këto që u cekën më lartë, si dhe në përputhje të plotë me Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues (neni 15), në mënyrë unanime mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi dhe i rekomandon Ministrin të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë marrjen e vendimit përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB – it,
2. MASHT-it,
3. Rektorit të Universitetit,
4. Sekretarit të Përgjithshëm,
5. Të përmendurit.



Dr. sc. Sabri Sadiku

Kryesuesi i Këshillit Drejtues